



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:080816

Datë: 09.02.2021

Numri i dokumentit: 01485775

C.nr.1628/20

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarja Mirvete Alidema, kryetare e trupit, gjyqtarëve porotë-Nazim Shurdhani dhe Gani Alidema, anëtarë të trupit, në çështjen juridike të propozuesve: B. Th nga fshati ..., Komuna e Kamenicës, të cilin e përfaqëson me autorizim Selami Rexhepi avokat nga Gjilani dhe Q. Th nga fshati ..., Komuna e Gjilanit, të cilën sipas autorizimit të caktuar nga Zyra Rajonale për ndihmë juridike falas në Gjilan, e përfaqëson Faredin Ymeri avokat nga Gjilani, për zgjidhjen e martesës me propozim të përbashkët, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe jo publik, të datës 05 Shkurt 2021, mori këtë:

AKTGJYKIM

ZGJIDHET Martesa-kurora me nr. rendor.13 e lidhur më datën ... para personit të autorizuar të Zyrës së Gjendjes Civile në ..., Komuna e Kamenicës, me numër serik M ... dhe me numër të referencës ..., në mes të propozuesve:

B. Th i lindur më datë ..., në Vranjë, Republika e Serbisë, tani me vendbanim në fshatin ..., Komuna e Kamenicës, nga babai I. Th dhe nëna Z. Th me shtetësi Kosovare dhe

Q.Th, e lindur më datë ..., në Gjilan, me vendbanim në fshatin ..., nga babai U. A dhe nëna Sh.A me shtetësi Kosovare, në të cilën martesë, të njëjtit nuk kanë patur fëmijë dhe as që pritet të kenë.

I. Shkurorëzohen në pajtim me dispozitën e nenit 68 pika 2 dhe 69 pika 2 të Ligjit për Familjen i Kosovës.

II. Obligohet Zyra e Gjendjes Civile në fshatin ..., Komuna e Kamenicë, që ta bëjë ndryshimin në Librin Amzë të Kurorëzuarve.

III. Shpenzimet e procedurës të shkaktuar në këtë çështje paraprakisht i bart secila palë veç e veç.

A r s y e t i m

Fillimisht, paditësi B. Th, nga fshati ..., Komuna e Kamenicës, në këtë gjykatë më datë 25.03.2020, ka paraqitur padi ndaj të paditurës Q. Th nga ... , Komuna e Gjilanit, për zgjidhjen e martesës. Paditësi në padi ka theksuar se të njejtit janë njoftuar në muajin Mars të vitit 2017, pasi që paditësi ishte me qëndrim në Zvicer dhe kishte ardhur me familje në Gjilan, ku ishte takuar me të paditurën Q. H. Në fillim raportet kishin qenë të mira, mirëpo me kalimin e kohë të njehta raporte ishin prishur deri në atë masë sa që jeta e tyre e përbashkët ishte bërë e padureshme, ashtu që nga muaji Gusht i vitit 2019, i kishin ndërprerë të gjitha format e kontaktit dhe komunikimit mes tyre, ashtu që vazhdimi i kësaj martese kishte qenë i pakuptimt dhe i pamundshëm. Për këtë arsye i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave të aprovet si e bazuar kërkesëpadi e tij. Mirëpo në shqyrtimin gjyqësor të datës 03.02.2021, i autorizuarit i të paditurës e ka pranuar kërkesëpadinë e paditësit ashtu që në mbështetje të nenit 68 pika 4, padia e paditësit është shëndrruar në propozim të përbashkët për shkurorëzim dhe shqyrtimi gjyqësor është mbajtur sipas propozimit të përbashkët për zgjidhjen e martesës.

Gjykata lidhur me këtë çështje më datën 03.11.2020 dhe më datën 03.02.2021 ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor ku i autorizuari i propozuesit ka deklaruar se palët ndërgjyqëse kanë lidhur martesë më datë 22.02.2017, në Zyren e Gjendjes Civile në..., Komuna e Kamenicës. Ka shtuar që propozuesi ishte me qëndrim të përkohshëm në botën e jashtme dhe propozueses i kishte premtuar rregullimin e dokumentacionit për bashkim familjar. Duke u bazuar në faktin se në fillim raportet mes tyre ishin të mira, por me kalimin e kohës këto raporte kishin filluar të keqësoheshin ashtu që për shkak të mospërputhjes së karaktereve në mes tyre, kjo martesë definitivisht në muajin Gusht të vitit 2019 ishte shkëputur dhe të njejtit nuk kishin kontakt në mes veti. Po ashtu ka shtuar se meqenëse edhe nuk kanë patur fëmijë ata nuk kanë dashur që bashkësinë e tyre martesore ta vazhdojnë duke qenë se për shumë gjëra nuk kanë arritur që të mirren vesh andaj nuk e kanë kundërshtuar që kjo martesë e tyre të shkurorëzohet-prisheet.

I autorizuari i propozueses ka deklaruar se është fakt se propozuesit kanë lidhur martesë në Zyrën e Gjendjes Civile në fshatin... më datën 22.02.2017, ku të njejtit kanë menduar që bashkësia e tyre martesore do të jetë për një kohë më të gjatë, por meqë nuk kanë mundur që të pajtohen për arsye të ndryshme dhe të vazhdojnë bashkësi martesore , ashtu që definitivisht në muajin Gusht të vitit 2019 janë ndarë definitivisht dhe që nga ajo kohë ata jetojnë ndaras nga njëri tjetri.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e të provuarit ka administruar këtë provë: Çertifikatën e martesës e evidentuar me numër rendor 13, me numër serik M ... dhe me numër të referencës ...

Meqenëse sipas nenit 84. parag.1 të LFK, kur kemi të bëjmë me marrëveshje të përbashkët për shkurorëzim, faktet e paraqitura në propozim nuk hetohen nga ana e gjykatës, atëherë në procedurën e provave gjykata vetëm ka bërë leximin e tyre dhe ka konstatuar se ndërgjyqësit kanë lidhur martesë te Shërbimi i Gjendjes Civile në Komunën e Kamenicës, më datë 22.02.2017 e evidentuar me numër rendor 13, me numër serik M ... dhe me numër të

referencës ... dhe se nga kjo bashkësi martesore të njëjtit nuk kanë patur fëmijë dhe as që pritet të kenë.

Gjykata duke u bazuar në nenin 68 pika 4 dhe 69 pika 2 të Ligjit për Familjen i Kosovës, e aprovoi propozimin e propozuesve për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, duke vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi pasi që janë plotësuar kushtet ligjore të parapara në neni 69 paragrafi 2 i LFK-ës, në të cilin parashihet se: “Shkaqet e shkurorëzimit janë në mes tjerash: *jeta e padurueshme e bashkëshortëve... dhe shkurorëzimi me marrëveshje të dyanshme*”.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi ashtu që e obligoi Zyrën e Gjendjes Civile në Kamenicë, që ta bëjë ndryshimin në Librin Amzë të Kurorëzuarve.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit ashtu që secila palë t’i bartë shpenzimet e procedurës duke u bazuar në nenin 452 pika 4 të LPK-së.

Pas komunikimit të aktgjykimit mbi aprovimin e kërkesëpadisë, të autorizuarit e propozuesve njëzërit kanë deklaruar se heqin dorë nga e drejta e paraqitjes së ankesës dhe që aktgjykimi të bëhet i formës së plotëfuqishëm në momentin e hartimit nga ana e gjykatës.

Duke u bazuar si më lartë e në mbështetje të neneve 68 pika 2, 68 pika 4 dhe nenit 69 pika 2 të LFK lidhur me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr. 1628/20 ,më datë 05 Shkurt 2021

Kryetarja e trupit – gjyqtarja
Mirvete Alidema

UDHËZIM JURIDIK: Ky aktgjykim është i plotëfuqishëm me datën 03.02.2021 ngase palët kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë pasi që gjykata e ka komunikuar aktgjykimin.